



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec
KUVENID I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 0164 Nr. i faq./Br.str./No.pg 80

Data/Datum/Date 30 / 06 / 2025

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 253 të Ligjit Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 57/2009"), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, kërkesës së Avduramon (Isen) Isma, Samir (Xhemali) Rama dhe Nijazi (Asllan) Shala nga Rahoveci me Nr. Prot. 1839 e datës 23.05.2025, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për konstituimin e të drejtës së kalimit (servitutit sendor)

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa e Avduramon (Isen) Isma, Samir (Xhemali) Rama dhe Nijazi (Asllan) Shala nga Rahoveci për konstituimin e të drejtës së servitutit sendor (të drejtës së kalimit) në parcelën publike kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-05483-0 në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur przhina, në posedim të Komuna e Rahovecit, në sipërfaqe prej 223m² (dyqind e njëzet e tre metra katrorë) e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4808m² (katër mijë e tetëqind e tetë metra katrorë).
2. E drejta e kalimit në pjesën e parcelës kadastrale të cekur në nenin 1 të këtij vendimi ka gjerësinë në fillim 6.56m (gjashtë pikë pesëdhjetë e gjashtë metra) ndërsa në fund ka 4.91m (katër pikë nëntëdhjetë e një metër) dhe në gjatësinë nga ana e majtë 36.73m (tridhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e tre metra) dhe nga ana e djathtë 32.44m (tridhjetë e dy pikë dyzet e katër metra).
3. Krijimi i të drejtës së kalimit në pjesën e parcelës kadastrale të cekura në nenin 1 dhe 2 të këtij vendimi i dedikohet Avduramon (Isen) Isma për parcelën kadastrale P-71510057-08970-1, Samir (Xhemali) Rama për parcelën kadastrale P-71510057-05471-0 dhe Nijazi (Asllan) Shala për parcelën kadastrale P-71510057-08970-2, të gjithë nga Rahoveci, të cilët janë posedues të pronave private, e të cilët nuk kanë qasje në rrugën publike dhe si bartës të të drejtës së kalimit sipas këtij vendimi do të kenë mbrojtjen e të drejtës së autorizuar dhe në kohë të pacaktuar për shfrytëzimin e të drejtës së kalimit, respektivisht rrugës si e mirë publike, e cila rrjedh nga e drejta e pronësisë në paluajtshmërinë shërbyese të tokës komunale, me kusht që rregullimin dhe meremetimin e kësaj rruge ta kryejnë me shpenzimet e veta.
4. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e pronës në librat kadastral.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.

6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.64/25
Më datë:30.06.2025

